



Në bazë të nenit 113 paragrafit 1 dhe 3 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale ("Fleta Zyrtare e MZ", nr. 02/18, 34/19, 38/20, 50/22 dhe 84/22), e në lidhje me nenin 5 të Vendimit mbi organizimin mbi mënyrën e punës së administratës lokale të Komunës së Tuzit ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale", nr. 043/20) dhe Vendimit mbi fillimin e procedurave për plotësimin e vendit të punës, numër 01-031/22-9650 prej më 29.09.2022, Sekretariati për vetëqeverisje lokale - Zyra për burimet njerëzore, shpall:

### SHAPLLJE PUBLIKE

#### për nevojat e Shërbimit të kryetarit të Komunës së Tuzit

#### 1. Nëpunësi/sja për punë të përgjithshme

- Ekzekutues: 1, në kohë të pacaktuar;
- I2 nivel i kualifikimit shkollorë;
- Pa pervojë pune.

#### Dokumentacioni i nevojshëm:

- formulari i paraqitjes për vendin e lire të punës (Formularin e paraqitjes për vendin e lirë të punës kandidatët mund ta nxjerrin në web faqen e Komunës së Tuzit [www.tuzi.org.me](http://www.tuzi.org.me) ose drejtpërdrejt në arkivin e Komunës së Tuzit),
- Curriculum Vitae – CV,
- fotokopja e letërnjoftimit biometrik e vërtetuar;
- diplomë ose vërtetim mbi përfundimin e nivelit dhe llojit të arsimit të vërtetuar;
- vërtetimin se nuk është denuar për vepër penale që e bën të papërshtatshëm për të punuar në organet shtetërore, e siguron organi sipas detyrës zyrtare.

Periodha e provës në punë është e obligueshme për zyrtarin shtetërorë i cili për herë të parë lidh marrëdhënie pune në kohëzgjatje të pacaktuar në organin shtetërorë. Periodha e provës zgjatë një vit.

Kandidatët janë të detyruar që Zyrës për burime njerëzore (në tekstin e mëtejme: Zyrja) të dorëzojnë me formularin e paraqitjes origjinal dokumentacionin ose fotokopjet e vërtetuara të dokumentacionit.

Me organin shtetëror nuk mund të lidh vend pune personi i cili është përdorues i të drejtës në pension, në pajtim me ligjin.

Zyrtari shtetëror, gjegjësisht nëpunësi i cili e ka realizuar të drejtën në paketën për shkurtim nga puna nuk mund të lidhin vendin e punës në organin shtetëror ose personin juridik, në periudhën prej një viti nga dita e pagesës së paketës për shkurtim nga puna. Kufizimi nuk vlen për personin i cili e kthen shumën totale të paketës për shkurtimin e punës që ka pranuar.

Verifikimi i dijes, aftësisë, kompetencave dhe shkathtësive, varësisht prej kategorisë së vendit të punës do të bëhet në pajtim me nenin 115 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale ("Fleta Zyrtare e MZ", numër 02/18, 34/19, 38/20, 50/22 dhe 84/22), si dhe në bazë të nenit 17 të Rregullores mbi kriteret dhe mënyrën e hollësishme për verifikimin e dijes, aftësisë, kompetencave dhe shkathtësive për punë në organet shtetërore ("Fleta zyrtare e Malit të Zi", numër 050/18).

Mbi datën, vendin, dhe mënyrën e verifikimit, të kandidatëve nga lista, kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e shpalljes publike do të jenë të njoftuar përmes ueb faqes së Komunës së Tuzit, më së largu pesë ditë para ditës së verifikimit.

Dokumentacioni i kërkuar është i nevojshëm të dorëzohet në afat prej 15 ditëve nga dita e shpalljes së konkursit publik në zarf të mbyllur (në të cilin është e nevojshme të shkruhet: emri dhe mbiemri, adresa, kontakt telefoni, emri i organit dhe vendi i punës) në adresën:

**Komuna e Tuzit**  
**Sekretariati për vetëqeverisje lokale - Zyra për burime njerëzore**  
**Me shënim: për Shpallje publike për nevoja të Shërbimit të kryetarit të Komunës së Tuzit**

Kontakt tel: +38220875167;

**Përpunoi:**  
**Valbona Sinishtaj**  
**Përsôn zyrtar i autorizuar II**



**SEKRETARE,**  
**Marina Ujkaj**

